

VENDIM
Nr. 13, datë 15.1.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VEÇANTA DHE TË PROCEDURAVE
PËR PËRZGJEDHJEN, EMËRIMIN, VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË PUNË,
DISIPLINËN, LIRIMIN DHE SHKARKIMIN NGA DETYRA TË INSPEKTORIT
TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton kriteret e veçanta dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirimimin dhe shkarkimin nga detyra të inspektorit të përgjithshëm.

II. KRITERËT PËR PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN

Kandidati për inspektor të përgjithshëm, krahas kriterëve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 16, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duhet të plotësojë edhe këto kriterë të veçanta:

a) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” ose “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” ose të barasvlershme me to;

b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në pozicione të larta drejtuese në institucione publike ose private.

III. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT

1. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalenderike nga krijimi i pozicionit vakant të inspektorit të përgjithshëm, sekretari i përgjithshëm i institucionit përgjegjës, që ka në varësi Inspektoratin e Përgjithshëm, hap thirrjen për aplikim dhe ngre një komision *ad hoc* të përbërë nga:

- a) një përfaqësues nga institucioni që ka në varësi Inspektoratin e Përgjithshëm;
- b) një përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike;
- c) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

2. Njoftimi për aplikim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të institucionit përgjegjës dhe qëndron i hapur për një periudhë jo më pak se 7 (shtatë) ditë kalendarike.

3. Kandidati paraqet këto dokumente:

- a) kërkesën për aplikim;
- b) jetëshkrimin të përditësuar (CV);
- c) kopjen e diplomës dhe të listës së notave;
- ç) dëshminë e përvojës profesionale;
- d) vetëdeklarimin për konfliktin e interesit dhe papajtueshmërinë sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) kopjen e letërnjoftimit (ID);
- e) vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- ë) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
- f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimimin shtesë, publikimet, angazhimet akademike apo të tjera, të përmendura në jetëshkrim.

4. Komisioni *ad hoc* përfundon shqyrtimin e dokumentacionit dhe zhvillimin e intervistave me kandidatët, brenda një afati jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve.

5. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në një total prej 100 pikësh dhe përbëhet nga:

a) vlerësimi i dokumentacionit dhe i përvojës profesionale: deri në 60 pikë;

b) intervista e strukturuar me gojë: deri në 40 pikë.

6. Vlerësimi i dokumentacionit dhe i përvojës profesionale deri në 60 pikë realizohet sipas skemës së mëposhtme:

a) Deri në 10 (dhjetë) pikë për tejkallim të nivelit të arsimit, sipas kritereve të mëposhtme:

i. 5 pikë, për diplomë ekzekutive ose diplomë specializimi;

ii. 10 pikë, për gradë ose titull shkencor.

b) Deri në 20 (njëzet) pikë për tejkallim të përvojës në punë si drejtues në institucione publike apo private, sipas kritereve të mëposhtme:

i. 5 pikë, për 1 (një) vit përvojë shtesë;

ii. 10 pikë, për më shumë se 1 vit deri në 3 vjet përvojë shtesë;

iii. 20 pikë, për më shumë se 3 vjet përvojë shtesë.

c) Publikime, angazhime akademike: 10 pikë;

ç) Deri në 15 (pesëmbëdhjetë) pikë për trajnime ose kualifikime profesionale, sipas kritereve të mëposhtme:

i. 5 pikë, për 1 (një) deri në 3 (tre) trajnime ose kualifikime profesionale;

ii. 10 pikë, për 3 (tre) deri në 5 (pesë) trajnime ose kualifikime profesionale;

iii. 15 pikë, për më shumë se 5 (pesë) trajnime ose kualifikime profesionale.

d) Integriteti profesional në bazë të deklaratave, referencave dhe dokumentacionit plotësues: 5 pikë.

7. Komisioni harton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, të shoqëruar me renditjen sipas pikëve të grumbulluara, dhe ia paraqet sekretarit të përgjithshëm të institucionit përgjegjës brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga përfundimi i procesit të vlerësimit.

8. Komisioni *ad hoc* funksionon në përputhje me këto rregulla:

a) mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë të gjithë anëtarët;

b) vendimarrja bëhet me shumicë votash;

c) çdo anëtar nënshkruan një deklaratë mbi mungesën e konfliktit të interesit para fillimit të vlerësimit;

ç) në rast mungese të një anëtari, zëvendësimi bëhet nga institucioni përkatës brenda 3 (tri) ditëve kalendarike.

9. Komisioni garanton barazi, objektivitet dhe transparencë gjatë gjithë procesit të vlerësimit.

10. Inspektori i përgjithshëm emërohet në detyrë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të titullarit të institucionit përgjegjës që ka në varësi Inspektoratin e Përgjithshëm.

IV. MASAT DISIPLINORE DHE PROCEDURA DISIPLINORE

1. Në rastet kur ka indicie të arsyeshme për shkelje disiplinore, sekretari i përgjithshëm i institucionit përgjegjës, me iniciativë të tij ose pas informacionit zyrtar të ardhur nga institucione shtetërore, vendos fillimin e procedurës disiplinore dhe njofton me shkrim inspektorin e përgjithshëm për shkeljen e dyshuar dhe për fillimin e hetimit administrativ.

2. Sekretari i përgjithshëm i institucionit përgjegjës urdhëron ngritjen e një grupi të posaçëm për hetimin administrativ të inspektorit të përgjithshëm, duke mbledhur prova, dëshmi, raportime dhe deklarata, sipas natyrës së shkeljes së pretenduar.

3. Inspektori i përgjithshëm ka këto të drejta:

a) të paraqesë shpjegime me shkrim;

b) të zhvillojë një dëgjues me grupin e posaçëm, brenda një afati jo më të gjatë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e njoftimit;

c) të përfaqësohet nga përfaqësues ligjor.

4. Pas përfundimit të hetimit, grupi i posaçëm përgatit një raport përfundimtar, i cili i paraqitet sekretarit të përgjithshëm brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të këtij hetimi.

5. Sekretari i përgjithshëm i institucionit përgjegjës, pas administrimit të raportit përfundimtar, i njofton titullarit të institucionit rezultatet e raportit të grupit të posaçëm.

6. Sekretari i përgjithshëm i institucionit përgjegjës, në rast të konstatimit të shkeljes dhe në varësi të rrethanave të konstatuara, i propozon titullarit të institucionit përgjegjës, që ka në varësi Inspektoratin e Përgjithshëm, një nga masat disiplinore të mëposhtme:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra;
- c) largim nga detyra.

7. Titullari i institucionit përgjegjës, që ka në varësi Inspektoratin e Përgjithshëm, merr vendim për dhënien e njërës nga masat disiplinore të parashikuara në pikën 6, të këtij kreu.

V. VLERËSIMI I REZULTATEVE NË PUNË TË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

1. Inspektori i përgjithshëm i nënshtrohet vlerësimit të rezultateve në punë 1 (një) herë në vit nga titullari i institucionit, që ka në varësi Inspektoratin e Përgjithshëm.

2. Vlerësimi i inspektorit të përgjithshëm kryhet në bazë të performancës së tij profesionale, në përputhje me kriteret e përgjithshme, si më poshtë vijon:

- a) realizimi i objektivave institucionale të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit;
- b) cilësia dhe efektiviteti i veprimtarisë inspektuese;
- c) menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare në dispozicion të institucionit;
- ç) respektimi i dispozitave ligjore dhe i standardeve të etikës profesionale;
- d) transparenca dhe komunikimi me publikun;
- dh) nismat për përmirësim të punës dhe përdorimi i teknologjisë në proceset inspektuese;
- e) bashkëpunimi ndërinstitutional dhe përfaqësimi institucional.

VI. LIRIMI DHE SHKARKIMI NGA DETYRA

1. Inspektori i përgjithshëm lirohet dhe shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të titullarit të institucionit përgjegjës, që ka në varësi Inspektoratin e Përgjithshëm, sipas rasteve të parashikuara në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Sekretari i përgjithshëm i institucionit përgjegjës, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga marrja dijeni apo konstatimi i shkakut për lirimin apo shkarkimin nga detyra të inspektorit të përgjithshëm, i paraqet titullarit të institucionit raportin me faktet dhe rrethanat përkatëse.

VII. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohet Inspektorati i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama